



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 3856/Prot.

Tiranë, 25.06.2026

URDHËR

Nr. 333, Datë 25.06.2026

**“PËR MIRATIMIN DHE KALIMIN NËN ADMINISTRIMIN E DREJTORISË SË
NDIHMËS JURIDIKE FALAS TË QENDRAVE TË SHËRBIMIT TË NDIHMËS
JURIDIKE PARËSORE SARANDË”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar; të nenit 7, pika 2 të ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar; shkronjës “dh” të nenit 7 e shkronjës “gj” të nenit 8 të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” si dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 47 datë 13.03.2025,

URDHËROJ :

1. Miratimin e krijimit të qendrës dhe kalimin nën administrimin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas të Qendrave të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore në Sarandë, përmes mbështetjes financiare nga buxheti i shtetit.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I DREJTËSISË

Toni Gogu

